



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **86**

Prishtinë, më 14.9.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi, Salih Morina.

Mungoi : Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MBPZHR dhe MMPH.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 12.9.2012,
3. Shqyrtimi i projektligjeve për parqet nacionale,
4. Propozimi për ekspertin,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.9.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 12.9.2012.

3. Shqyrtimi i Projektligjeve për Parqet Nacionale

Kryetari i Komisionit falënderoi pjesëmarrësit dhe ministrin e MMPH për pjesëmarrje duke shpresuar që në këtë takim do të përfundoi “dosja P” siç e quajti shkresat për dy Projektligje të parqeve nacionale me gjithë vërejtjet dhe sugjerimet e deritanishme si dhe pajtime e mospajtime. Gjithashtu ai arsyetoi ftesën për kohët e ndara për dy ministri për ti ikur ngarkesave dhe polemikave të panevojshme gjatë mbajtjes së mbledhjes së komisionit. Në vazhdim shprehu qëndrimin se këto dy Projektligje duhet medoemos të kalojnë në Kuvend pa marr parasysh, ngase çdo shtyrje rrezikojnë pyjet tona, sidomos pas shkatërrimeve që u bënë nga zjarri në gusht të këtij viti. Ministria e Mjedisit, vazhdoi, në tërësi pajtohet me qëndrimin e deritanishëm të këtij Komisioni, marr parasysh edhe amendamentet e sotme, ndërkaq Ministria e Bujqësisë ka vërejtje tek parku i Sharrit që mos të përfshihen në park Koritniku dhe Breviku, por ky Komision nuk mund të pajtohet me faktin që edhe pak bimë sa kanë mbetur, të mos shpallen park. Ai konstatoi që demin e përafërt rreth 10-15 milion por **Nijazi Idrizi** reagoi se demin nuk mund të përshkruhet me fjalë, ngase është tepër i madh, dhe se 60 vjet duhen për ripërtëritje, përfundoi kryetari.

Liburn Aliu kundërshtoi amendamentin 4 duke sugjeruar të mbetet numri 100 si është në të dy projektligjet, të Bjeshkëve të Nemuna dhe të Sharrit dhe njëherit apeloi tek zyrtarët prezent të Ministrisë për ndaljen e prerjeve në Gërdevc të Sharrit përmes inspekcioneve përkatëse ku ka shumë prerje të drunjve të cilat pastaj damkohen nga zyrtarët komunal dhe kështu legalizohen prerjet.

Nijazi Idrizi propozoi shqyrtimin e këtyre dy projekteve bashkërisht me projektin për Pyjet e Kosovës i cili vetëm sa ka arrit në Kuvend, në mënyrë që mos të kemi përplasje nenesh, sidomos neni 61 i Pyjeve ku theksohet kompetenca e APK për Pyje. **Ministri Gashi** tha se ka lexuar këtë Projektligj dhe shtoi se ky nen ka të bëjë me shfrytëzimin ekonomik e jo për park nacional. **Nijazi Idrizi** reagoi dhe pyeti a do të thotë kjo se MMPH duhet ta themeloi edhe një APK në kuadër të saj për të menaxhuar me masën drusore dhe mbeti pranë qëndrimit se Ministria e Bujqësisë është ajo që duhet të bëjë menaxhimin e prerjeve, ndërsa MMPH të kujdeset për parkun nacional (deputeti e kishte fjalën për zonën e 3 të parkut nacional). U përgjigj prapë **Ministri** dhe tha se zona e 3 do të menaxhohet nga departamenti i MMPH bashkërisht me APK, por MMPH përkatësisht drejtoria e parkut do të jetë ombrella ku hyjnë edhe prerjet e pyjeve. Ky është qëndrimi i MMPH, përfundoi Ministri.

Liburn Aliu mbrojtja e pyjeve në territorin e parkut duhet te jetë nën menaxhim te Drejtorisë se parkut, ndërsa APK mund te japë kontribut në aspektin këshillues. Nëse mbetet ne përgjegjësi te APK-se do te kemi shkatërrim, bazuar ne përvojën e deritanishme.

Nijazi Idrizi sugjeroi të gjendet zgjidhja përmes Ministrisë së Energjetikës për burime alternative të nxemjes, në mënyrë që të kemi prerje të kontrolluara dhe të mbahet një debat me MMPH për burimet alternative të energjisë.

Nait Hasani : nëse e ki fjalën për Deçan, mund të them se ska nevojë ngase atje nuk ka më masë drusore (janë shkatërruar).

Liburn Aliu kërkoi përgjegje sa ka kompetenca APK në zonën e parkut, dhe pasi që **Hazër Dana** tha që nuk ka, ai konstatoi se pasi dallimi ne zonën e është tejet i dukshëm ne zonat ku janë parqet ne raport me zonat tjera, pra ne parqe pyjet janë me te ruajtura, menaxhimi duhet te mbetet përgjegjësi e drejtorisë se parkut.

Hazër Dana (drejtor i parkut Sharr) sqaroi më saktësisht dhe tha : brenda Parkut Kombëtar drejtoria e parkut menaxhon parkun me plan menaxhues në të cilin plan hyjnë edhe planet e APK dhe të gjitha planet tjera, dhe si rezultat kemi mbrojtjen e suksesshme të parkut Sharr, nga kufiri i së cilës dukshëm dallohet vendi ku nuk është shtrirë parku, ngase menjher përtej kufirit dallohen shkatërrimet. Prevalla është diçka tjetër (vazhdoi **Liburn Aliu** dhe **Nait Hasani**) ngase aty ndërtimet janë bërë me leje të caktuara ku nuk ka pasur ingerenca drejtoria e parkut.

Në vazhdim u miratuan amendamentet për dy projektet, ndërsa për amendamentin 5 të Bjeshkëve të Nemuna **kryetari** arsyetoi fillimin e punës së drejtorisë në janarin e vitit 2013 , ngase nëse tani

nuk miratohet Ligji, nuk ka gjasa të sigurohet buxheti. Amendamenti 6 u tha se duhet të vlej edhe për parkun e Sharrit, rreth çështjeve pronësore. Amendamentet e nënshkruara u proceduan menjëher pas mbarimit të mbledhjes për dy Projektligjet. **Kryetari** rreth Amendamentit 6 tha se kufiri ndërshtetror nuk ka nevojë të ceket ngase kufijt rregullohen me akte tjera dhe marrëveshje ndërkombëtare bilaterale.

Ministri Gashi duke pasur parasysh kundërshtimet nga zyrtarët e MB nga takimet e mëparshme lidhur me këto dy projekte, pyeti : këto votime dhe miratime a vlejné edhe për ata zyrtar. **Kryetari** pohoi dhe shtoi se zyrtarët e MB do të pyten për zgjerimin e parkut Sharr me çka ata nuk pajtohen. **Sekretari i MMPH** tha se mbeten pranë qëndrimit si është në Projektligj. **Fatos Lajçi** pyeti zyrtarët e MMPH për ndërtimet e deritanishme a do të mbeten, për çka Sekretari tha se ato nuk janë të lidhura me dispozitat që vlejné prej tani e tutje dhe shtoi se ato do të konsiderohen jolegale.

Para se të ndahen zyrtarët e MMPH nga anëtarët e Komisionit, **kryetari** inicoi çështjen e financimit të ekspertizave në komision nga ana e MMPH, ndërkaq **Liburn Aliu** konstatoi se kjo do të ishte konflikt interesi , ngase Komisioni ka fondin e vet dhe nuk mund të financohet për ekspertiza nga dikush tjetër. Sekretari i MMPH njoftoi se USAID është i gatshëm për këto çështje ndërsa zyra e Komisionit Evropian konkretisht mund të ndihmoi me ekspert në disa projekte, siç është ajo e ujërave etj. **Liburn Aliu** gjithashtu pyeti për “lejet e Prevallës” dhe a ka tejkalime me ato, të cilat sipas **Luan Nushit** janë dhënë nga Drejtoria e Urbanizmit në Prizren sipas planit që parasheh 5 tipe objektesh, ndaj ato tash e tutje do të konsiderohen ilegale dhe do të kenë trajtim ndryshe (nuk dha përgjigje se a do të rrënohen).

Takimi me zyrtarët e Ministrisë së Bujqësisë filloi me pyetjen e kryetarit çka sugjerojnë për Parkun e Sharrit dhe në përgjithësi, njëherit njoftoi për mundësinë edhe të një takimi, por nuk është sigurt, rreth çështjes së pavarësisë së APK apo ajo të hynë në kuadër të Drejtorisë së Parkut Kombëtarë.

Kapllan Halimi sekretar i MB, tha se ky takim është befasues për këtë ministri ngase qëndrimet e disa anëtarëve të këtij komisioni tani devijojné nga ato në vizitën e përbashkët në Austri, ku ka pasur marrëveshje (jo me shkrim) rreth asaj a duhet të shpallet parku Bjeshkët e Nemuna dhe pyjet me ekonomicitet a duhen të jenë pjesë e parkut apo jo. Për dëmet nga zjarri ai tha se nuk ka raport zyrtar, derisa ato kanë ndodhur në tërë Ballkanin gjatë verës. Në MB insistohet, vazhdoi, në zhvillim ekonomik të pyjeve dhe të përkufizohen si shtyll e zhvillimit ekonomik i vendit.

Kryetari potencoi faktin se vizita në Austri është bërë rreth pyjeve private, ndërkaq marrëveshje nuk ka pasur me shkrim. **Liburn Aliu** sqaroi se këto dy projekte tanimë janë miratuar në Kuvend, tani mund të flitet vetëm për ndryshime që mund të bëhen dhe assesi me heqje dore nga parku i cili është votuar në lexim të parë. Ai tha se për tu zhvilluar vendi duhet të mendojmë për një balancim në mes të shfrytëzimit të mirave të natyrës dhe mbrojtjes së natyrës, e jo për një shfrytëzim të vrazhdë siç është tani. Është e papranueshme që ne emër të zhvillimit ekonomik të behet shkatërrimi i pyjeve. Dëmi masiv duhet të ndalet dhe të caktohen prioritete të tjera të zhvillimit dhe jo duke u bazuar në shkatërrim të pyjeve.

Ahmet Zejnullahu kryeshef i APK, vazhdoi dhe konstatoi se qëndrim pozitiv MB ka pasur vetëm për Sharr, bile edhe aty është kërkuar zvogëlimi i sipërfaqes në Koritnik dhe Brevik, ngase mund të ndodhë privatizimi i Brezovicës që do të sjellë deri te aktivitetet e shtuara të prerjeve në zonën e 3 në bashkëpunim me Drejtorinë e parkut. Ai tha se roli i APK është monitorues për shkak të kalimit të kompetencave në Komuna, pyjet nuk mund të ndahen dhe se ato duhet të trajtohen prej një ministrie, ngase edhe Ligji thotë se ato në parkun kombëtar menaxhohen nga ministria e bujqësisë, ndaj si mund të menaxhohen nga MMPH kur në atë ministri nuk ka asnjë inxhinjer të pylltarisë. Qëndimi përfundimtar i MB është : nga Sharri të hiqet Koritniku dhe Breviku, ndërsa për Bjeshkët e Nemuna duhet të dakordohen dy ministritë.

Agron Bajraktari insistoi se në Austri është dakorduar MB me këtë Komision, mirëpo tani këtu në këtë mbledhje fillon çdo gjë prej fillimi. **Liburn Aliu** dhe anëtarët tjerë që kanë qenë në Austri kategorikisht mohuan këtë fakt rreth mosshpalljes së Parkut Kombëtar Bjeshkët e Nemuna. **Kapllan Halimi** tha : për të prer drunjt në zonat 2 dhe 3 MB duhet të formoi drejtori të veçanta, na nuk kemi buxhet për këto paralelizma.

Sevdije Lama : unë po ju pyes, si të miratojmë këto dy projekte me gjithë këto mospajtime.

Në vërejtjen e disa anëtarëve të komisionit për takime të kryetarit jashta Komisionit, **Kryetari** pohoi se ato takime (me zyrtar të MB dhe MMPH) kanë qenë në favor të takimeve të Komisionit, ngase Komisioni në fund vendos, siç bëri edhe sot. Kryetari potencoi faktin se është mundur ti harmonizoi qëndrimet midis dy ministrive. Zyrtarët e MB dolën nga mbledhja e Komisionit duke mos u pajtuar me qëndrimet e Komisionit.

Rreth propozimit të ekspertit Bashkim Pllana komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Emërohet eksperti i dytë Bashkim Pllana për Projektligjin e Regjistrimit të Bujqësisë, i cili në bashkëpunim me ekspertin Seid Abazi do të sjellin ekspertizat me shkrim në afatin që do të përcaktohet me termat e referencave me ekspertët të emëruar në mbledhjen e kaluar.

Mbledhja përfundoi në orën 13,40.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani